



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje//Department of Education

DATE	09.07.2026
NR.	05/487

PËR	Rrahman Jakupi, kryesuesi kuvendit të komunës
PËRMES	Qemajl Aliu, kryetar i komunës
NGA	Lulzim Sahiti, udhëheqës i sektorit të arsimit
LËNDA	PROPOZIM VENDIM



PROPOZIM-VENDIM

Për propozimin e dy përfaqësuesve të Komunës së Shtimes në Komisionin Përzgjedhës për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar

Në mbështetje të nenit 14, paragrafit 8, nënparagrafit 8.1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Komunale e Arsimit i propozon Kuvendit Komunal të Komunës së Shtimes miratimin e këtyre përfaqësuesve të Komunës së Shtimes në Komisionin Përzgjedhës për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar:

1. **Labinot Rexhaj** – i punësuar në Drejtorinë Komunale të Arsimit, Drejtor i IAAP-së, në cilësinë e përfaqësuesit të DKA-së, i cili, në përputhje me nenin 14, paragrafin 8, nënparagrafin 8.1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024, njëherësh ushtron edhe funksionin e kryetarit të Komisionit Përzgjedhës;
2. **Feride Qorrolli Lubishtani** – eksperte e pavarur e arsimit, profesoreshë e matematikës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në cilësinë e përfaqësueses së Komunës së Shtimes në Komisionin Përzgjedhës.

Arsyetim

Neni 14, paragrafi 8 i Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve,

Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar përcakton se Komisioni Përzgjedhës për institucionet arsimore në varësi të komunës përbëhet nga dy përfaqësues të komunës, të cilët propozohen nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe miratohen nga Kuvendi Komunal, një përfaqësues nga MASHTI dhe dy përfaqësues të Këshillit Drejtues të institucionit arsimor në cilësinë e vëzhguesve.

Në përputhje me nënparagrafin 8.1 të këtij neni, anëtari i parë i propozuar nga DKA duhet të jetë i punësuar në Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe njëherësh ushtron funksionin e kryetarit të Komisionit Përzgjedhës, ndërsa anëtari i dytë mund të jetë ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë ose përfaqësues i këshillit të prindërve në nivel komunal me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e arsimit.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, si dhe në përvojën profesionale dhe kompetencat e kandidatëve të propozuar, Drejtoria Komunale e Arsimit vlerëson se z. Labinot Rexhaj dhe znj. Feride Qorrolli Lubishtani i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr. 19/2024 për t'u emëruar si dy përfaqësuesit e Komunës së Shtimes në Komisionin Përzgjedhës.

Andaj, i propozohet Kuvendit Komunal të Komunës së Shtimes që ta shqyrtojë dhe ta miratojë këtë propozim-vendim.